



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
IDENTITEK SHA
DIVIZIONI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Datë 16.06.2026

Proces - Verbal - Tipi i kontratës – Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje software për menaxhimin e burimeve njerëzore”

VLERA E FONDIT LIMIT: 1,460,833 (një milion e gjashtëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e tre) **Lekë, (pa TVSH).**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor “Identitek” Sha ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 9001:2015 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.
2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatë ISO 27001:2022 (ose të përditësuar), e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e objektit të prokurimit. Për këtë ai duhet të paraqesë çertifikatën përkatëse të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Certifikimet ISO janë certifikata që iu akordohen kompanive të cilat manifestojnë menaxhim të lartë bazuar në standartet ndërkombëtare të vendosura në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar që e rregullon këtë fushë. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera

fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë të kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojë dhe aftësi zbatuese në lidhje me natyrën dhe vlerën e kontratës, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më e vogël se vlera e fondit limit. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
 - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.
 - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2. Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se disponon një stafit të kualifikuar me të paktën 3 punonjës të diplomuar në fushën e IT (inxhinieri informatike, informatike ekonomike, shkenca kompjuterike etj), për realizimin e këtij shërbimi, me profile si më poshtë:

- 1 (një) punonjës Specialist software
- 1 (një) punonjës me profil Programues për migrim të dhënash / integrim
- 1 (një) punonjës i certifikuar që kryen trajnim për programin e ofertuar

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diplomën përkatëse
- Kontratën e punës e vlefshme ose kontratë bashkëpunimi
- CV përkatëse
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore;

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” I ndryshuar, dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, e ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, në lidhje me kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Ky numer minimal është kërkuar duke u bazuar në natyrën e shërbimit që do të ofrohet nga OE, siç është edhe implementimi i software për burimet njerëzore. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do të ofrojë shërbim asistencë përgjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që është në dispozicion të Ak përgjate gjithë periudhës së mirembajtjes për zbatimin e kontratës, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Kriteret teknike janë hartuar nga Znj. Enxhi Kondi, në cilësinë e specialistit të fushës në njësinë e prokurimit.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave: Data: 06.07.2026; Ora: 12:00; Vendi: “IdentiTek” Sh.A, Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.